TERRA MARKETING

# SI TË KEM MË SHUMË NDJEKËS

WE HAVE ACCESSIBLE ANSWERS FOR YOU!

NUMRI I LARTË I NDJEKËSVE NË RRJETET SOCIALE SHIHET SHPESH SI MATËSI MË I RËNDËSISHËM I NDIKIMIT QË MUND TË KENI NË TREG OSE NË OPINIONIN E PËRGJITHSHËM. *POR A JANË NDJEKËSIT TUAJ REALISHT TË ANGAZHUAR E TË DEVOTSHËM NDAJ PUBLIKIMEVE TUAJA?*

NDJEKËSIT NUK DUHEN TRAJTUAR THJESHT SI NJË SHIFËR PËR T’U ARRITUR SI QËLLIM NË VETVETE, POR SI VLERË E SHTUAR E CILA DUHET TË JETË E INTERESUAR PËR PËRMBAJTJEN E PUBLIKIMEVE TUAJA.



- TASHMË, PLATFORMA “TERRA WORLD” MUNDËSON PËR HERË TË PARË NË SHQIPËRI, MATJEN, KRAHASIMIN DHE ANALIZËN E TË DHËNAVE TË RRJETEVE SOCIALE NË KOHË REALE. ZOTËRUESIT E INFORMACIONIT MUND TA PËRDORIN KËTË PUSHTET PËR TË NDRYSHUAR RREGULLAT E LOJËS SË TYRE PËR TË QENË NË KRYE TË TREGUT.

- NË NJË KOHË KUR INFORMACIONI PËRFTOHET NË KOHË REALE NËPËRMJET NJË “SCROLL” E NJËKOHËSISHT NË SHUMË PLATFORMA SOCIALE, ANGAZHIMI I AUDIENCËS DREJT NJË PUBLIKIMI APO LAJMI BËHET GJITHMONË E MË E VËSHTIRË. SIPAS STUDIMEVE, 3-10 SEKONDA ËSHTË KOHA MESATARE QË NJË PERSON SHPENZON PËR TË PARË NJË VIDEO NË FACEBOOK DHE INSTAGRAM E AKOMA MË E SHKURTËR KOHA E QËNDRIMIT NË NJË POSTIM.

Ndaj, ju nuk duhet të pyesni “Si të kemi më shumë ndjekës”, por “**Si të rris angazhimin e audiencës sime?”**

Nëse dëshironi që audienca juaj të shfaqë interes ndaj publikimeve tuaja, ju duhet të krijoni një marrëdhënie më të qëndrueshme me të për të patur një ndërveprim më të lartë në kohështrirje me afatgjatë. Çelësi i suksesit qëndron në origjinalitetin e publikimit, ku audienca duhet të identifikohet me mendimin, vlerat dhe zërin tuaj.



# KUJDES

NJË NGA GABIMET QË BËHET SHPESH, ËSHTË SHTRIRJA DREJT NJË AUDIENCE MË TË LARTË ME QËLLIM ARRITJEN E SHIFRAVE TË LARTA TË NDJEKJES, DUKE ANASHKALUAR *GRUPIN E VËRTETË TË INTERESIT* QË JU NDJEK DHE ËSHTË BESNIK. INVESTOHUNI TE GRUPI JUAJ I INTERESIT, PËRGJIGJET E TË GJITHA PIKËPYETJEVE TUAJA GJENDEN BRENDA KOMUNITETIT TUAJ. PËRQENDROHUNI TË LEXONI MENDJEN E TYRE PËR TË PARASHIKUAR LËVIZJEN E RADHËS, E KOHA DO UA SHPËRBLEJË ANGAZHIMIN.

MOS HEZITONI TË PROVONI TENDENCAT DHE *TRENDET E REJA* PËR AQ KOHË SA ATO I SHKOJNË PROFILIT TUAJ. PUBLIKIMET TUAJA DUHET TË ZGJOJNË INTERES TË VAZHDUESHËM DHE ËSHTË E NATYRSHME QË NDËRSA JU NGRIHENI E TË NDRYSHONI NË RRUGËTIMIN TUAJ, AUDIENCA JUAJ TË RRITET BASHKË ME JU. NDRYSHIMI ËSHTË SHPESH INTERESANT DHE SFIDUES, MEGJITHATË, DUHET TË TREGOHENI TË KUJDESSHËM PASI NËSE NDRYSHIMI ËSHTË DRASTIK, JU MUND TË HUMBNI SHUMË NDJEKËS DUKE ZHGËNJYER AUDIENCËN BESNIKE NË KËMBIM TË NDJEKËSVE TË RINJ.

GJATË RRUGËTIMIT TUAJ PUBLIK, MUND TË NDESHENI ME KOMENTE JO TË MIRA. NDONËSE KOMENTE TË TILLA MUND TË JENË TENDENCIOZE OSE TË PAVËRTETA, JU NUK DUHET T'I FSHINI APO ANASHKALONI ATO, POR DUHET T'I PËRGJIGJENI KRITIKAVE NË FORMË ETIKE E TË SOFISTIKUAR. *PUBLIKU E VLERËSON KUR NDIHET I DËGJUAR*, MADJE E VLERËSON TRANSPARENCËN DHE KOMUNIKIMIN DIREKT, PASI KJO E BËN MARRËDHËNIEN MES JUSH DHE TIJ MË NJERËZORE. KJO VËRTETËSI SJELL ANGAZHIM MË TË LARTË TË AUDIENCËS, MADJE MUND TË FITONI DHE ZEMRAT E NDJEKËSVE TË RINJ GJATË KËTIJ PROCESI.

# KONKURRENCA



Studiojeni konkurrencën tuaj për të mësuar më shumë mbi strategjinë që duhet të ndiqni. Mësoni nga gabimet e tyre duke mos riskuar profilin tuaj dhe parashikoni hapin që duhet të ndiqni.

# WE HAVE ACCESSIBLE ANSWERS FOR YOU!

KONTAKT

https://terra.marketing/

